

Trajnimi në temë “Formimi i partneriteteve dhe rrjetëzimi në funksion të lobimit dhe përfaqësimit”

Në periudhën prej 14 deri 16 nëntorit 2008 në Strugë u mbajt trajnim në temë “Formimi i partneriteteve dhe rrjetëzimi në funksion të lobimit dhe përfaqësimit” në të cilën morën pjesë gjithsej 28 pjesëmarrës (20 përfaqësues nga organizata joqeveritare nga Resnja, Ohri, Struga dhe Manastiri, 8 përfaqësues nga institucione lokale nga Resnja dhe Struga). Trajnimin e realizuan Mario Veljkoviç dhe Fatmir Saraçini, kurse i njëjti u organizua me qëllim të zgjerimit të diturive nga fusha e partneriteteve dhe rrjetëzimit, kyçe aktive në proceset e lobimit dhe përfaqësimit drejtuar kah interesat e tyre dhe përfshirja sociale e bashkësive etnike jo shumicë. Trajnimi përfshiu prezantime, diskutime dhe zbatim praktik të veglave për formimin e partneriteteve dhe rrjetëzimeve.

Si hyrje në trajnim paraqiste aktiviteti praktik i quajtur *Galeria*, ku secili pjesëmarrës kishte mundësi të jep mendimin e tij në lidhje me çështjen e partneritetit si fenomen nëpërmjet ilustrimit apo tekstit të shkruar. Në vazhdim të trajnimit, pjesëmarrësit duke punuar në ekipe, diskutuan për partneritetin si dukuri nga aspekti i përfitimeve dhe pengesave që paraqiten gjatë punës. Pastaj nëpërmjet qasjes interaktive u prezantuan, diskutuan dhe u dhanë shembuj që kanë të bëjnë me analizën e profilit dhe mënyrës së punës të aktorëve të mundshëm në procesin e formimit të partneriteteve lokale. Aksent u vu në programet, strukturën dhe procedurat për punë një njësitë e vetëqeverisjes lokale, organizatat joqeveritare dhe institucionet. Në sesionin në vijim grupi pati mundësi të mëson si zhvillohet procesi i analizës praktike të bashkësisë, por edhe ti përcakton faktorët aktorët dhe shfrytëzuesit që kanë të bëjnë me problemet e bashkësive etnike jo shumicë. Në vazhdim të trajnimit pjesëmarrësve iu ofrua një model praktik për fillimin e procesit të rrjetëzimit. Grupet e formuara punuese definuan 3 tema aktuale gjegjësisht probleme të cilët do të mund të jenë shkas për ngjalljen e partneriteteve dhe rrjeteve ndër-sektoriale, edhe atë: zvogëlimi i numrit të nxënësve rom në SHF “Gorgi Sugarev” nga Manastiri, pamundësia për të luajtur basketboll në Resnje edhe pse ekziston interesimi dhe kushtet e pavoritshme për realizimin e aktiviteteve fizike – sportive në SHF “Slavejko Arsov” nga Podmoçani. Tema e fundit në kuadër të këtij trajnimi ishte lotimi, përfaqësimi dhe formimi i partneriteteve me mediumet, ku u prezantuan më shumë shembuj për përfaqësim të suksesshëm në R. e Maqedonisë.

Trajnimi u organizua nga Fondacioni Institut Shoqëri e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me zyrat lokale të projektit në Resnje dhe Strugë (Qendra për përkrahjen e bashkësisë Resnjë dhe Shoqata për zhvillimin e aktivizmit “AKVA” nga Struga, ish Qendra për përkrahjen e OJQ-ve).